

Universiteti i Tetovës  
Fakulteti i Shkencave Mjekësore  
Cikli i tretë i Studimeve të Doktoraturës

№ i Kërkesës: \_\_\_\_\_  
№ i Vlerësimit: \_\_\_\_\_  
Nr.-Ej. 22-360/1  
20.02.2020 viti/rod.  
Tetovë - Tetova

Fakultetit të Shkencave Mjekësore  
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së  
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Albulena Beadini** të miratuar nga **Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës**, u formua Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Albulena Beadini** në përbërje: **Prof.Dr. Lutfi Zylbeari, Prof. dr Nasir Bexheti, Prof.dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr Nevzat Elezi, Prof. Dr Sadi Bexheti**, Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatës **Albulena Beadini** paraqet këtë:

### Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Albulena Beadini** me titull: “Prevalenca e parathormonit dhe përcaktimi i nivelit të vitaminës D dhe joneve të  $Ca^{2+}$  tek pacientët me osteoporozë“.

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Albulena Beadini** si në aspektin stukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *162 faqe, 26 figura, 21 tabela dhe 13 grafikone.*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës *Albulena Beadini* është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura.*

## I. HYRJA

Tek „*Hyrja*„ kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmijë shkencore hulumtuese.

Osteoporozë definohe si çrregullim i indit kockor që karakterizohet me humbje të masës kockore dhe çrregullim të strukturs së kockës, duke mundësuar rritjen e rezikut për fraktura dhe fragjilitet të kockave në përgjithësi. Konsiderohet si sëmundje më e përhapur rreth moshave të 50-ta. Prevalenca e kësaj sëmundje në bazë të gjinisë më e shprehur është tek femrat krahasuar me meshkujt, gjegjësisht një raport 3:1.

Është e njohur që humbja e masës kockore që ndodh tek femrat gjatë premenopauzës është e ndërlidhur me deficietin e estrogjenit dhe disbalancin hormonal karakterstik që ndodh tek gratë gjatë menopauzës dhe premenopauzës.

Kryesisht tek këto grupe të pacienteve haset edhe një disbalans i hormoneve paratiroide gjegjësisht nivel i lartë i këtijë hormoni që shfaq veprimin e vet mbi osteoblastet duke shkaktuar plakjen dhe vdekjen e tyre, zvogëlimin e nivelit të vitaminës D dhe zvogëlimin e nivelit të joneve të joneve  $Ca^{2+}$ .

Menopauza është proces i ndërprerjes së ciklit menstrual tek femrat zakonisht rreth viteve të 50-ta me çrast ndodhin ndryshime edhe hormonale sepse vjen gjer tek zvoglimi i estrogjenit, progesteronit që janë stimulus kryesor të hormoneve folikulostimulues (FSH) dhe hormonit luteinizues (LH) ku me uljen e nivelit të këtyre hormoneve vjen gjer te ulja e nivelit të vitaminës D dhe joneve të kalciumit të cilët rregullojnë metabolizmin e niveli të joneve kalcium

dhe vitaminës D në eshtra(1).Duke u bazuar nga të dhënat e OBSH ne Unionin Europian statistikat tregojne se raporti i humbjes se densitetit te ashtit në mes meshkujve dhe femrave është në raport 1:3 që tregon se femrat janë më të rezikuara nga osteoporoza,humbja e densitetit te ashtit që sjell gjer te fraktura e ashtit.Duke patur parasysh se në vendin tonë nuk kemi një statistikë të këtillë për grate në periudhën e premenopazes,menopauses dhe postmenopauzes për nivelin e këtyre parametrave te parqitura më lartë duke ju bashkëngjitur edhe BMI,menyren e te ushqyerit dhe te jetuarit si dhe aktivitetin fizik te tyre dhe kushtet e pergjithshme socio-ekonomike dhe struktura gjeografike me klime kontinentale ishte edhe arsyeja kryesore ne hulumtimin e kesaj teme dhe ketyre parametrave.

## II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,**” kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtijë punimi.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me përcaktimin e incidencës dhe prevalencës për disbalans hormonal që shfaq efektin në masën kockore, kryesisht mes parathhormonit, calcitoninës, vitamies D dhe joneve të kalciomit tek femrat në fazën e premenopauzës, menopauzës dhe postmenopauzës.

Qëllimi i këtij studimi do të paraqes gjendjen reale të këtyre parametrave biokimik përmes të cilëve do të paraqitet pasqyra reale e nivelit të dëmtimit të qelizave kockore.

### III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,**„ kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë decide problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë të thuktë metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Për kryerjen e testeve meret gjak venoz (nga vena) më së shpeshti bëhet në krahë në nivelin e brylit sepse në këtë vend venët janë më në sipërfaqe, relativisht të mbushura mirë me gjak si dhe lehtë fiksohen. Pas lidhjes së krahut me ezmark, vijon pastrimi me alkool 70% të vendit (krahut) ku mendojmë se kemi detektuar venët më sipërfaqësore të pacientit, për tu mbushur vena më mirë me gjakë duhet që dy – tri herë të shtërngohet dhe lëshohet grushti i krahut nga i cili do të merret gjak, zakonisht me gishtërinjtë e dorës së majtë fiksohet vena dhe shpohet lëkura e pastaj me kujdes shpohet edhe vena, nëse kemi bërë shpuarjen e saktë të venës atëherë epruveta me antikuagullant mbushet me gjak deri në shkallën 2,5 ml (ose 250 µl) dhe e njëjta është tundur që të bëhet përzierja e gjakut me antikuagullantin. Në mikroepurutetë ka një vend specifik ku duhet shënuar emri i pacientit (numri i pacientit) që mos të ngatërohet me eperuvetën e ndonjë pacienti tjetër.

Pasi që kemi bërë këtë procedurë të parë vijon në procedurën në vazhdim me futjen e epruvetës në centrifuge për tu centrifuguar 10 min me rrotullime 2000/min. Pas centrifugimit plazma e gjakut gjendet në epruvet mbi elementet e gjakut që janë të ndarë në fund të epruvetës. Pas centrifugimit, serumi i përfituar ndahet nga epruveta me ndihmën e pipetës së pasterit dhe vendoset në epruvet të veçantë për të realizuar testin e kontrollit të markerëve serologjik .

Serumi i gjakut është një lëngë i verdhë i kthjellët me pH të dobët bazike. Në të nuk gjenden të tretura komponentet e domosdoshme për kuagullim të gjakut sepse serumi i gjakut fitohet pas kuagullimit të gjakut të marrur dhe kuptohet se komponentët për kuagullim para së gjithash fibrinogjeni është shëndruar në fibrin, prandaj edhe nuk është i pranishëm në serum in e gjakut.

#### IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „**Rezultatet**„, kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëvizje shkencore hulumtuese.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me osteoporozën dhe vitaminën D. Rezultatete fituara do të shërbejnë fushës së osteologjisë dhe të osteoporozës në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka parqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojmë krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referente të shume autoreve botëror që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

#### V. PËRFUNDIMI

Tek „**Përfundimi**„, kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëvizje shkencore hulumtuese.

Gratë humbin çdo vit rreth 1% të densitetit kockor gjatë dhe pas menopauzës. Afërsisht 35% e grave i nënshtrohen humbjes së masës kockore duke filluar që në periudhën e premenopauzës. Parametrat biokimikë mund të sigurojnë një informacion të rëndësishëm mbi aktivitetin e osteoklasteve dhe osteoblasteve. Markerët biokimikë që reflektojnë formimin e kockës dhe proceset e resorbimit, përbëjnë pjesën e rëndësishme për të monitoruar metabolizmin e kockës dhe humbjen e përshpejtuar të masës kockore tek gratë në periudhën e postmenopauzës.

Faktorët e rizikut të identifikuar për osteoporozën janë: mosha e madhe, duhanpirja, alkooli, pesha e vogël trupore, inaktiviteti fizik, marrja në sasi të ulët e kalciumit, nivele të ulta të vitaminës D dhe gjendja e Vitamines D ka për funksion ruajtjen e vlerave normale të kalciumit dhe fosforit në gjak, ndihmon në absorbimin e kalciumit, ndihmon në formimin dhe ruajtjen e eshtrave të forta,.

Kështu në përgjigje ndaj mungesës së vitaminës D mund të kemi ndryshime të mëdha në nivelin e këtyre parametrave dhe kjo mund të ndikojë për një humbje më të shpejtë të masës kockorë tek gratë në menopauzë.

Rezultatet tona do të tregojnë për një insuficiencë të theksuar të vitaminës D te gratë gjatë periudhës së menopausës dhe duke paraqitur kështu një risk faktor të rëndësishëm në shfaqjen e frakturave dhe zvogëlimin e densitetit të masës kockore.

## VI. BIBLIOGRAFIA

Tek „**Bibliografia**„ kandidatja **Albulena Beadini** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.


Tek ky punim doktore është i fokusuar në literaturën më standarde më bashkëkohore dhe në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara e plotësojnë dhe i japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse u përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiqar edhe nga ky aspekt ky punim i plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Duke u bazuar në të dhënat së punimit të disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i disertacionit të doktoraturës do të sjellë një risi tek prevalenca e parathormonit, nivelit të vitaminës D dhe joneve të kalciumit tek pacientët në periudhën e menopauzës dhe pacientët me osteoporozë të theksuar, prandaj konsiderojmë se ky punim do të kontribuojë fushës së mjekësisë në përgjithësi dhe fushës ortopedisë dhe osteoporozës në veçanti, prandaj duke u bazuar në këto të dhëna të mirëfillta, kërkojë nga **Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta miratojë pozitivisht punimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Albulena Beadini** me titull: **“Prevalenca e parathormonit dhe përcaktimi i nivelit të vitaminës D dhe joneve të Ca<sup>2+</sup> tek pacientët me osteoporozë”**

Tetovë më, 28.01. 2020

Anëtarët e komisionit:

Prof. Dr. Lutfi Zylbeari




---

Prof. Dr. Nasir Bexheti



---

Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha



---

Prof. Dr. Nevzat Elezi



---

Prof. Dr. Sadi Bexheti



---